

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**PLANET SCENTS SHPK**

Sot me daten 25/01/2024 (dymijë e njëzet e kater ), une ortaku themelues :

*Uarda SHEHU, shtetase shqipëtare, e datëlindjes 11 Maj 1987, lindur dhe banuese në Durres, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, pajisur me kartë identiteti me Nr. 1755110761*

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008" Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007"Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin " **PLANET SCENTS**"SHPK.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë emrin " **PLANET SCENTS**" SHPK dhe emer tregtar " **Oui by Maison de Parfum**" .

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në adresen:

**Durres, Lagjja 1, Rruga Taulantia, Zona Kadastrale 8512,Godine me nr pasurie 24/122-N1.**

**NENI 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen :

- Tregti i produkteve te parfumerise dhe kozmetikes, parfumeve te ndryshme, produkteve të ndryshme te bukurise e të estetikës, kremra te ndryshem, shampo, aromatizues të llojeve të ndryshme, produkte parafarmaceutike, produkte të higjenes, produkte ushqimore të bukurisë, të trajtimit të lëkurës, detergjentë të llojeve të ndryshme, produkte hotelerie, artikujve te konsumit te gjere, etj. Import dhe eksport i produkteve te sipershenuara, te parfumerise, kozmetikes, etj .

- Shpërndarje e produkteve të parfumerisë dhe kozmetikës.
- Trajnime në fushën e parfumerisë dhe kozmetikës.
- Tregtim i artikujve të ndryshëm industrialë, ushqimorë, konfeksione dhe veshjesh të ndryshme, aksesore të ndryshme, bizhuteri, etj.
- Shitje në internet, on-line të produkteve të ndryshme.
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohej me ligj.

#### **NENI 4** **KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 (një) kuota me vlerë nominale të një kuote prej 100,000 lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

1. **UARDA SHEHU** zotëron 1 (një) kuota me 100% pjesëmarrje në kapitalin e Shoqërisë me vlerë nominale prej 100,000 lekë.

2.

#### **NENI 5** **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

#### **NENI 6** **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administratori i shoqërisë do të jetë **UARDA SHEHU**, e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themelues.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

**NENI 7**  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**NENI 8**  
**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 9**  
**LIKUIDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**  
**Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.  
Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar

**ORTAKU THEMELUES TË SHOQËRISË**

**UARDA SHEHU**

